

XIX. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Kuadri Ligjor

Kuadri ligjor i përditësuar në kuadër të zgjedhjeve të vitit 2021, u përshtat¹ për aplikim edhe në zgjedhjet e 6 marsit 2022. Është hera e parë që kandidatët për kryetar të bashkive dhe subjektet përkatëse zgjedhore, në një proces të pjesshëm zgjedhor, do të duhet të raportojnë mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës elektorale.

Page | 1

Në zgjedhjet e datës 6 mars 2022, morën pjesë pesë parti politike dhe 19 kandidatë për kryetar bashkie. Secili prej tyre është subjekt vetëdeklarimi, monitorimi dhe auditimi sa i përket aktivitetit financiar në funksion të fushatës përkatëse zgjedhore.

TRANSPARENCA

Vetëdeklarimi i subjekteve zgjedhore

Ligji² parashikon se subjektet zgjedhore duhet t'a dorëzojnë raportin e vetëdeklarimit financiar në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.

Sa i përket aktivitetit financiar të kandidatëve duhet të jetë nën mbikëqyrjen e financierit të partisë. Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve llogariten si të ardhura dhe shpenzime nga partia përkatëse, dhe duhet të përfshihen në raportin financiar të fushatës zgjedhore të partisë.

Kandidatët për kryetarë bashkie kanë detyrimin të regjistrojnë, dokumentojnë dhe raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së tyre duke përdorur një formular tip raportimi të miratuar nga Komisioni Rregullator në KQZ.

Bashkë me raportin financiar të partisë politike duhet të bashkëngjiten edhe kopjet e raporteve të kandidatëve.

Bazuar në analizën e kryer mbi raportet e vetëdeklarimit, evidentohen një numër problematikash në procesin e transparencës së bërë nga vetë subjektet zgjedhore në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet.

Formatet e raportimit të miratuara dhe përdorura edhe në këto zgjedhje mbartnin problematika, të cilat KRIIK i ka ngritur në raportin e vëzhgimit të zgjedhjeve³ të vitit 2021. Problemet vijuan të mbetën të njëjtat, jo vetëm për shkak të formatit që mbart problematika, por edhe për shkak të mungesës së përgjegjshmërisë nga ana e subjekteve zgjedhore në plotësimin e tyre. Raportet vijnë të dorëzohen dhe publikohen në format “.pdf” pavarësisht se plotësohen në excel. Ato nuk janë të plotësuara në të gjitha pjesët përbërëse të tyre. Pjesët sqaruese të shpenzimeve dhe

¹ [Vendimi nr. 9 datë 29.01.2022](#) dhe [Vendimi nr. 13 datë 04.02.2022](#) Komisioni Rregullator.

² Kodi Zgjedhor Neni 92/3 pika1.

³ Për më shumë shih [Raporti Final i Vëzhgimit](#) pjesa VIII.3.1. Vetëdeklarimi i subjekteve zgjedhore, faqe 89.

dhurimeve, qofshin këto në para apo në natyrë, janë thuajse të paplotësuara. Vijon të mbetet e pa specifikuar kush ka paguar për një zyrë të caktuar zgjedhore, partia apo kandidati. LSI sikurse në 2021 ka deklaruar sërish si dhurim në natyrë zyrat e dhëna nga bashkitë për aktivitetin normal të partisë dhe jo për fushatë. Gjithashtu seksioni i mitingjeve është totalisht i paplotësuar, ka raste të mospërputhjes së zërit të shpenzimit me të dhënat sqaruese për të, etj.

Page | 2

Përpos problemeve në përmbajtjen e raporteve, rezulton shqetësim madhor dorëzimi jashtë afateve ligjore apo edhe mosdorëzimi fare i tij në KQZ. Kështu Partia Demokratike e Shqipërisë ka dorëzuar raportin e vetëdeklarimit financiar jashtë afatit ligjor në KQZ, dhe përpos kësaj gjashtë kandidatët për kryetar bashkie të propozuar prej saj nuk dorëzuan raport vetëdeklarimi financiar, sipas parashikimeve ligjore.

Sa i përket pjesës tjetër të subjekteve zgjedhore, rezulton se 2⁴ nga 13 kandidatë dhe 2⁵ nga 4 parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje kanë dorëzuar raporte ku deklarojnë 0 të ardhura dhe shpenzime.

Mirëkuptimi i treguar nga KQZ, deri në kufijtë e shkeljes së ligjit, duke pranuar raporte në formate jo të standartizuara, të paplotësuara apo me probleme thelbësore në përmbajtjen e tyre, duhet të përfundojë në funksion të ndërgjegjësimit të subjekteve zgjedhore për rëndësinë e plotësimit të saktë të raporteve të vetëdeklarimit.

Detyrimi i dorëzimit të raporteve të vetëdeklarimit në formatin e miratuar nga KQZ në Excel, nga subjektet zgjedhore, duhet të parashikohet në Kodin Zgjedhor bashkë me detyrimin e KQZ për t'i mos i pranuar këto raporte nëse nuk janë të tillë, apo nëse nuk janë tërësisht të plotësuar, si dhe publikimin në faqen e internetit në të njëjtin format.

Me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës, i gjithë procesi i verifikimit paraprak të raporteve, nëpërmjet komunikimit zyrtar të KQZ me subjektin, deri në pranimin e versionit përfundimtar të raportit, duhet të jetë publik në një dosje që hapet në faqen e internetit të KQZ për secilin subjekt. Dokumentet duhet të publikohen në faqen e internetit në kohë reale.

Bilanci i aseteve dhe detyrimeve

Kodi zgjedhor⁶, parashikon detyrimin ndaj subjekteve zgjedhore, që përpos dorëzimit të raportit të vetëdeklarimit financiar sipas formatit të miratuar nga KQZ, të depozitojë edhe bilancin e aseteve dhe detyrimeve të tyre për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, pra për periudhën 20.01.2022 – 06.03.2022.

Ky parashikim i Kodit Zgjedhor bën të mundur qartësimin e situatës financiare të partisë politike, në nisje të periudhës kur partia do të raportojë në KQZ nëpërmjet raportit të vetëdeklarimit, si dhe situatën financiare të partisë politike në ditën e zgjedhjeve, që është fundi periudhës për të cilën raportohet.

Përmbushja e këtyre detyrimeve ligjore të parashikuara, si dhe një raportim i saktë e konform standardeve të kontabilitetit, bën të mundur të sigurohet një panoramë më e qartë mbi aktivitetin

⁴ Kandidatë Blerim Shera dhe Rahim Spahiu të propozuar prej Partisë Socialiste.

⁵ Partia Demokristiane dhe Partia Lëvizja e Re.

⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/3 pika 2.

financiar të subjektit zgjedhor, duke siguruar transparencë më të plotë dhe bërë funksional mekanizmin e kontrollit nëpërmjet verifikimit të KQZ-së dhe auditëve ligjorë.

Vetëm Partia Socialiste ka dorëzuar në KQZ një bilanc të tillë, por dokumenti i dorëzuar jo vetëm që nuk është bilanc, por plotësimi i një tabele ku deklarohet blerja e një lavatriçeje, që më së paku është jo serioze nga ana e subjektit.

Page | 3

Kjo është një situatë e përsëritur, duke qenë se edhe në zgjedhjet e 2021 pjesa dërrmuese e subjekteve nuk dorëzuan bilancin e aseteve dhe detyrimeve, por edhe ato dokumente që u dorëzuan në funksion të këtij detyrimi nuk ishin një bilanc që përmbush detyrimet e mësipërme.

KQZ duhet të angazhohet në hartimin e një formati të standartizuar për bilancin e aseteve dhe detyrimeve si dhe ndërgjegjësimin e subjekteve zgjedhore lidhur me rëndësinë e këtij raporti, nëpërmjet marrjes së masave administrative përkatëse.

Problematika që lidhen me raportet e vetëdeklarimit

Publikimi në web-in e partisë

Vendimi i Komisionit Rregullator përcakton⁷ detyrimin e subjekteve zgjedhore për të publikuar në faqen zyrtare të internetit një kopje të raportit të vetëdeklarimit për fushatën zgjedhore.

Nga partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 6 mars 2022, tre parti kanë një faqe interneti aktive, por asnjëra prej tyre nuk ka publikuar raportin e vetëdeklarimit për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022. Kjo është një situatë e përsëritur, pasi edhe në zgjedhjet e vitit 2021 këto raporte nuk u publikuan nga partitë.

Raporte të pa plota dhe me mangësi

Format e vetëraportimit financiar për partitë dhe kandidatët, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të përfshijnë thuajse çdo detaj lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet. Vetëm një plotësim i detajuar i çdo fushe të raportit do të mund jo vetëm të jepte panoramën e qartë të situatës, por edhe të lejonte kontrollin nga aktorë të tretë, në funksion të rritjes së transparencës dhe kontrollit të tyre.

Sikurse në zgjedhjet pararendëse, vërehen problematika të përsëritura dhe thuajse të njëjta, pavarësisht se volumi i deklarimeve për shkak të karakterit të pjesshëm të këtyre zgjedhjeve, ishte shumë më i ulët.

Thuajse në asnjë raport vetëdeklarimi plotësimi nuk është bërë në të gjitha pjesët e tij, të parashikuara për t'u plotësuar sipas formatit përkatës.

⁷ [Vendimi nr. 13, datë 06.04.2021](#), Komisioni Rregullator, Neni 3 pika 4.

Në disa raporte mungojnë të dhëna të ndryshme në fusha të ndryshme raporteve, që janë në seksionin e të ardhurave, por edhe të shpenzimeve⁸.

Page | 4

Dhurime më shumë se 50.000 lekë cash

Kodi Zgjedhor⁹ përcakton se dhurimi i fondeve jo publike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë duhet të kryhet vetëm nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e posaçme të hapur nga subjekti apo kandidati.

Ndërkohë që partitë politike nuk kanë asnjë të ardhur në formën e financimeve jo publike në para, disa kandidatë¹⁰ kanë deklaruar në raportet e tyre dhurime të vlerave monetare më të mëdha se 50 mijë lekë të kryera cash, ndërsa një kandidatë¹¹ deklaroi se ka përfutur të tilla por pa e specifikuar mënyrën, pra cash apo nëpërmjet llogarisë bankare.

Shpenzime të kryera pas përfundimit të fushatës

Në seksionin e shpenzimeve të fushatës, përfshihet çdo shpenzim që kryhet për qëllime të fushatës pavarësisht datës se kur është bërë, por gjithmonë përpara datës së zgjedhjeve. Ndërsa likuidimi i faturës ose i kësteve përfundimtare mund të bëhen edhe pas datës së zgjedhjeve.

Në raportet e 4 kandidatëve¹² janë deklaruar shpenzime me datë të faturës në muajt prill dhe maj 2022, pra jashtë periudhës së fushatës zgjedhore.

⁸ Konkretisht në raportin e Znj. Emirjana Sako kandidatë e PS në Bashkinë Durrës, ndërkohë që zëri i shpenzimit është media sociale, fatura justifikuese është nga Vodafone. Të dyja pjesë që nuk lidhen me njëra tjetrën dhe shprehimi mungon. Në po të njëjtin raport në seksionin e shpenzimeve është plotësuar vetën zëri i shpenzimit dhe fatura përkatëse, duke lënë bosh çdo pjesë tjetër.

Në raportin e Znj. Eriselda Sefa, kandidatë e PS për Bashkinë Lushnjë, seksioni i dhurimeve në natyrë nuk përmban shprehimin se çfarë është dhurimi konkretisht. Gjithashtu tek dhurimet e përfutura në para nuk ka specifikuar mënyrën e dhurimit, cash apo nëpërmjet bankës. Edhe në seksionin e shpenzimeve nuk janë plotësuar të dhënat shprehuese të shpenzimit dhe datat e faturave përkatëse.

Në raportin e Z. Edison Memolla, kandidat i PS në Bashkinë Rogozhinë, lidhur me seksionin e të ardhurave janë përfshirë dy tabela me të dhëna të ndryshme nga njëra tjetra dhe që për më tepër nuk përputhen më tabelën përmbledhëse në faqen e parë.

Në raportin e Partisë Demokratike mungojnë shprehime dhe plotësime tek pjesa e shpenzimeve, ku janë përfshirë vetëm të dhënat e faturës përkatëse.

⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 92/2 pika 2.

¹⁰ Znj. Emirjana Sako në raportin e saj si kandidatë e Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 92.775 lekë cash. Z. Edison Memolla në raportin tij si kandidat i Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 120.590 lekë cash.

Z. Ardian Muka në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë i ka dhuruar vetes shumën 415.000 lekë cash (të ndarë në tre këste dhuruar në 120.000 lekë, 150.000 lekë dhe 145.000 lekë). Z. Bardh Spahia në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë i ka dhuruar vetes 91.420 lekë cash (të ndarë në dy këste 40.000 lekë dhe 51.420 lekë).

¹¹ Znj. Eriselda Sefa, në raportin e saj si kandidatë e Partisë Socialiste ka marrë dhurime nga persona të tretë në vlerën 99.875 lekë dhe 100.000 lekë por nuk e ka specifikuar mënyrën e dhurimit.

¹² Z. Edison Memolla në raportin tij si kandidat i Partisë Socialiste ka deklaruar shpenzime në muajin prill. Z. Premtim Kryemadhi kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë ka deklaruar shpenzime në muajin maj. Z. Lulzim Vrana kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë në ka deklaruar shpenzime në muajt prill dhe maj. Z. Bardh Spahia në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë ka deklaruar shpenzime në muajin maj.

Përpos faktit që kemi të bëjmë me shpenzime të cilat janë kryer jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, evidentohet moskorrektësi edhe nga ana e subjekteve që i kanë lëshuar këto fatura, pasi ato deklarojnë kryerje të shpenzimeve në funksion të një aktiviteti elektoral, pas datës së zgjedhjeve. Kjo është në kundërshtim me legjislacionin tatimor në fuqi¹³, sipas të cilit fatura përpihet dhe nxirret nga subjekti ofrues apo shitës në momentin e kryerjes së shërbimit, pavarësisht momentit kur kryhet likuidimi i saj.

Page | 5

Të ardhura të përfituara pas përfundimit të fushatës

Përpos shpenzimeve, edhe të ardhurat apo financimi për efekt të fushatës zgjedhore, nga cilido burim qoftë ai, ka synim mbështetjen e partisë apo kandidatit në maksimalizimin e platformës përkatëse, nëpërmjet kontributit financiar. Në këtë funksion duhet që ky financim të realizohet përpara ditës së zgjedhjeve.

Nga raportet e vetëdeklarimit 6 kandidatë¹⁴ kanë deklaruar pranimin e dhurimeve në para pas përfundimit të zgjedhjeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet

Kuadri ligjor përcakton si burime të ligjshme të financimit për fushatën zgjedhore fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore; të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor; dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime, si dhe huatë ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët.

Të ardhurat¹⁵

Për zgjedhjet e pjesshme ligji nuk parashikon dhënien e fondeve specifike për fushatë elektorale nga buxheti i shtetit, sikurse ndodh në zgjedhjet e rregullta periodike. Por, kjo nuk përjashton faktin që partitë mund të përdorin fondet e buxhetit, të cilat i kanë arkëtuar në llogaritë përkatëse bankare si fonde vjetore¹⁶.

¹³ [Udhëzimi Nr.24 datë 02.09.2008](#) “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i Ministrisë së Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 51.1 “Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit”.

¹⁴ Z. Ardian Muka, kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë në Bashkinë Durrës ka deklaruar se ka marrë donacion nëpërmjet llogarisë bankare në muajin prill. Z. Bardh Spahia kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë në Bashkinë Shkodër ka deklaruar se i ka dhuruar vetes para cash në muajin maj. Z. Lulzim Vrana kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë në Bashkinë Vorë ka deklaruar se i ka dhuruar vetes para cash në muajin prill dhe maj. Z. Premtim Kryemadhi kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë në Bashkinë Dibër ka deklaruar se i ka dhuruar vetes dhe ka pranuar nga të tretët financim në para në muajin maj. Z. Edison Memolla kandidat i Partisë Socialiste në Bashkinë Rrogozhinë ka deklaruar se i ka dhuruar vetes para pas ditës së zgjedhjeve. Znj. Emirjana Sako kandidate e Partisë Socialiste në Bashkinë Durrës nuk e ka specifikuar datën e dhurimit në seksionin përkatës të raportit.

¹⁵ Për më shumë detaje të shifrave shih Shtojcën I “Të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore”.

¹⁶ 3 parti politike, konkretisht Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë deklaruar si të ardhura të transferuara nga llogaritë e tjera të partisë shumën 20.146.710 lekë, përkatësisht 2,797,851 lekë PS, 13.484.202 lekë PD dhe LSI 3,864,657 lekë.

Nga raportet e vetdeklarimit të subjekteve zgjedhore, rezulton se shuma totale e të ardhurave të tyre në funksion të fushatës zgjedhore ishte 32.896.997 lekë, nga të cilat 10.899.176 lekë ishin të ardhura të arkëtuara prej kandidatëve. Pjesa tjetër e të ardhurave ishin të ardhura të transferuara nga fondet e vetë partisë¹⁷ nga kuotat e anëtarësisë¹⁸, dhe dhurime në natyrë¹⁹.

Vlen të theksohet që nuk ka asnjë financim jo publik në para për partitë politike, ndërsa dhurimet në natyrë janë në pjesën dërrmuese zyra zgjedhore.

Page | 6

Ndërkohë vijon të mbetet e paqartë shuma e të ardhurave të deklaruara nga kuotat, tek partitë politike. Sikurse në vitet dhe zgjedhjet e mëparshme, nuk ka një panoramë të qartë të numrit të anëtarëve të partisë, shumës së dhënë prej tyre si kuotizacion në parti, mënyra si janë arkëtuar etj.

Lidhur me kuotat e anëtarësisë, kuadri ligjor duhet të parashikojë mekanizma të kontrollit të tyre.

Të ardhurat e kandidatëve²⁰

Sikurse partitë politike të cilat i kanë propozuar, edhe kandidatët në raportet përkatëse kanë të njëjtat probleme. Nga totali prej 19 kandidatësh, 6 të propozuar nga PD nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi, ndërsa 2 nga 13 të tjerët kanë dorëzuar raport ku deklarojnë 0 të ardhura dhe shpenzime.

Shuma totale e të ardhurave të kandidatëve është 10.899.176 lekë, nga të cilat 5.449.395 lekë janë dhurime në para nga persona të tretë, 3.033.637 lekë janë financim i vetë kandidatëve për fushatën e tyre dhe 2.504.884 lekë janë dhurime në natyrë, të cilat përfshijnë kryesisht zyra zgjedhore, ambiente për takime elektorale apo edhe fletëpalosje.

Shpenzimet

Kodi zgjedhor parashikon se shpenzim për fushatë zgjedhore konsiderohet çdo shpenzim që bëhet për qëllime të fushatës, pavarësisht kohës kur është kryer ai, apo nëse është bërë nga partia, kandidatët apo degët e saj.

Shuma totale e shpenzimeve të realizuara në funksion të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 6 mars 2022, për subjektet, është 32.877.886 lekë nga të cilat 10.880.065 janë shpenzime të kryera nga kandidatët.

Zërat për të cilët subjektet kanë shpenzuar janë, shpenzimet për mitingje që zënë 56% të totalit, shpenzimet administrative të cilat zënë 18% , konsulenca 11%, materialet promociionale 11%, transporti 3%, etj.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ 1,658,720 lekë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë.

¹⁹ 192,391 lekë dhurime në natyrë për subjektet.

²⁰ Për më shumë detaje të shifrave shih Shtojcën 2 “Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve”.

Periudha e përfshirë në shpenzimet e deklaruara, referuar faturave përkatëse, është nga muaji janar deri në maj.

Sikurse përmendur më sipër, deklaratimet e shpenzimeve janë të mangëta duke qenë se raportet nuk janë të plotësuara në çdo fushë të tyre. Përpos deklaratimit, i cili duhet të jetë i plotë dhe i vërtetë, edhe dokumentimi i duhur i shpenzimeve sipas legjislacionit tatimor në fuqi, është pjesë shumë e rëndësishme e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore në funksion të transparencës dhe zbatimit të ligjit. Përputhshmëria dhe rregullsia e faturave tatimore është objekt i punës së auditëve ligjorë, të emëruar nga KQZ.

Page | 7

Shpenzimet e kandidatëve²¹

Shuma totale e shpenzuar nga 11 kandidatë të cilët kanë deklaruar aktivitet financiar në raportet e tyre të vetëdeklarimit është 10.968.804 lekë.

Ndryshe nga partitë politike të cilat kanë deklaruar 0 shpenzime për media, në shpenzimet e kandidatëve mediat zënë pjesën më të madhe me 74% të totalit të shpenzimeve. Zëra të tjerë ku kandidatët kanë shpenzuar janë mitingjet me 9%, materialet promocionale 5%, transporti 4%, media sociale 3%, etj.

Shpenzimet për aktivitete elektorale

Shuma e shpenzuar në total për zhvillimin e aktiviteteve elektorale, sipas përlllogaritjeve të zërit mitingje, tubime dhe aktivitete në fushatë është 13.380.741 lekë, nga të cilat 12.405.754 lekë u shpenzuan nga 3 subjekte zgjedhore²² dhe 974,987 lekë të shpenzuara nga 6 kandidatë²³.

Plotësimi i plotë i të dhënave në seksionin e posaçëm të parashikuar në formatet e raportimit lidhur me mitingjet do të jepte një panoramë sistematike të mitingjeve të realizuara, përfshirë evidentimin më të plotë dhe të qartë të shpenzimeve. Kjo pjesë e formatit të raportimit kërkon që subjekti zgjedhor të japë informacion financiar rreth mitingjeve të fushatës, sipas vlerës së shpenzuar për çdo event, çka jep mundësinë dhe siguron një pasqyrë të mjaftueshme të shpenzimeve për të konkluduar se sa mund të kushtojë një aktivitet i tillë.

Nga shqyrtimi i bërë i të gjithë raporteve, vetëm Partia Demokratike e ka të plotësuar këtë seksion të raportit, si dhe kandidatja e Partisë Socialiste për kryetare të Bashkisë Durrës, e cila e ka plotësuar pjesërisht duke vendosur një listë me mitingje të realizuara por për vetëm dy prej tyre koston përkatëse.

Kjo është një problematikë vijuese në raportet e vetëdeklarimit, e vërejtur në vazhdimësi të raportimit të subjekteve zgjedhore për fushatat elektorale, duke e lënë seksionin e mitingjeve të

²¹ Po aty.

²² Partia Demokratike 9.184.202 lekë, Partia Socialiste 3.124.872 lekë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 96.680 lekë.

²³ Shih Shtojcën 2 “Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve”.

pamundur për t'u përcaktuar, jo vetëm në kosto por edhe në numër. Një situatë e tillë passjell pamundësi kontrolli nga KQZ, nëpërmjet kryqëzimit me të dhënat e mbledhura nga monitoruesit.

Shpenzimet për zyra zgjedhore

Numri real i zyrave zgjedhore të hapura prej subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve nuk ka qenë i qartë në asnjë proces zgjedhor të realizuar në Shqipëri. Në vazhdimësi janë evidentuar mospërputhje midis numrit të deklaruar nga subjektet zgjedhore, numrit të zyrave të identifikuara nga monitoruesit e KQZ, si dhe numrit të evidentuar nga vëzhguesit e pavarur në rastet kur kjo është realizuar²⁴. E gjithë kjo situatë, implikon jo vetëm mos deklarim nga ana e subjekteve, por një situatë pazbatueshmërie të ligjit në raport me detyrimin për njoftimin e bashkisë përkatëse në momentin e hapjes së zyre zgjedhore si dhe, paqartësinë e pagimit, përpos qerasë, të të gjitha detyrimeve të tjera që implikon ajo.

Subjektet zgjedhore, konkretisht PD, PS dhe LSI²⁵ kanë deklaruar 14 zyra zgjedhore²⁶ të hapura, ndërsa kandidatët²⁷ kanë deklaruar 21 zyra zgjedhore. Duke i trajtuar edhe zyrat e LSI si zyra zgjedhore, rezulton të kemi një numër total prej 35 zyrash të hapura në funksion të fushatës elektorale për zgjedhjet e datës 6 mars 2022.

Nga shqyrtimi i raporteve të monitoruesve rezulton se këta të fundit kanë evidentuar në terren 93 zyra zgjedhore²⁸ të hapura.

KRIIK nuk ka patur në terren vëzhgues të angazhuar përgjatë gjithë fushatës, e për rrjedhim nuk ka kryer evidentim të numrit të zyrave në terren. Kjo nuk na lejon një krahasim edhe më të plotë, duke patur të dhëna nga palë të treta, e më pas një përjasje të kostove referuar çmimeve të tregut, sikurse në zgjedhjet e vitit 2021²⁹.

Gjithsesi, diferenca në numrin e zyrave të deklaruara nga subjektet e kandidatët dhe atij të evidentuar nga monitoruesit është mjaft e lartë, dhe ky është një fenomen që kërkon rritjen e vëmendjes nga ana e KQZ në ndërgjegjësim e kontrollim, por edhe nga bashkitë të cilat duhet të gjejnë mekanizmat e detyrimit të subjekteve për përmbushjen e detyrimit ligjor të njoftimit të bashkisë për hapjen e tyre.

²⁴ Shih Raportin final të vëzhgimit të Zgjedhjeve të vitit 2021 të KRIIK, dhe Raportin përfundimtar të vëzhgimit të zgjedhjeve të vitit 2017 të KVV.

²⁵ LSI ka deklaruar si zyra zgjedhore zyrat e dhëna nga Bashkitë për funksionimin normal të partisë dhe për fushatën elektorale. Madje bashkitë e përfshira në deklarim nuk janë bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022.

²⁶ Konkretisht PS 9 zyra zgjedhore dhe LSI 5 zyra zgjedhore.

²⁷ Vetëm gjashtë kandidatët e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” kanë deklaruar në raportet e tyre hapjen e zyrave zgjedhore. Shih Shtojcën 2 “Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve”.

²⁸ Partia Socialiste 31 zyra, Partia Demokratike 30 zyra dhe Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (LSI) 32 zyra zgjedhore.

²⁹ Për më shumë shih [Raporti Final i Vëzhgimit](#) pjesa VIII.2.2.2. Shpenzimet për zyra elektorale, faqe 83.

Shpenzimet për media

Kodi Zgjedhor³⁰ parashikon se çdo media duhet të depozitojë në KQZ, përpara fillimit të fushatës zgjedhore, tarifën që ajo aplikon lidhur me reklamën politike përgjatë fushatës zgjedhore. Ky detyrim ligjor u plotësua nga 22 media³¹, pas kërkesës drejtuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Përpos faktit që pati media të cilat nuk dorëzuan tarifën përkatëse në KQZ, pati rast të dorëzimit të tarifave për të cilat deklaroheshin se nuk aplikoheshin për partitë politike nga media përkatëse³², çka tregon moskuptimin dhe shkeljen e atij kuadri rregullator ligjor të miratuar posaçërisht për këtë qëllim, pra për të ndaluar financimin apo favorizimin në çfarëdo mënyre të fushatës së partive politike nga media.

Page | 9

Gjithashtu ligji³³ parashikon një limit kohor prej 90 minutash për reklamë politike për secilën parti, gjysma e së cilës duhet të ofrohet falas nga media përkatëse. Nga monitorimi i AMA, rezultoi që në disa televizione ky limit kohor është tejkaluar nga media dhe subjekte zgjedhore.

Ndërkohë që partitë politike nuk kanë deklaruar asnjë shpenzim të kryer për reklamë politike në media, kandidatët e propozuar prej tyre deklarojnë në total 8.078.480 lekë të shpenzuara si pagesë ndaj kompanive mediatike për transmetim reklame në median përkatëse.

Sipas monitorimit të kryer nga AMA, në mediat shqiptare janë transmetuar gjatë 15 ditëve të fushatës zgjedhore 545 minuta reklamë nga 14 televizione.

Një problem madhor i evidentuar nga KRIIK, lidhur me shpenzimet e subjekteve zgjedhore për reklamë në media në zgjedhjet e vitit 2021, ishte diferenca shumë e lartë midis shifrës së deklaruar prej subjekteve dhe kostos reale të reklamës së transmetuar, referuar kjo minutazhit të monitoruar nga AMA³⁴.

KRIIK ka realizuar një përlllogaritje të përafërt të shumës reale të shpenzuar nga subjektet zgjedhore për reklamë në media, duke ju referuar minutave të reklamës të monitoruara nga AMA dhe çmimit mesatar të saj, referuar tarifave të depozituara nga mediat dhe publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Vërehet se shumata e shpenzuar është rreth 22.000.000 lekë kundrejt shumës 8.000.000 lekë të deklaruar.

Në diferencën prej 14.000.000 lekë, pjesa më e madhe rreth 9.000.000 lekë është tek Koalicioni Shtëpia e Lirisë, e më pas tek Partia Demokratike me rreth 3.000.000 lekë e Partia Socialiste me rreth 2.000.000 lekë³⁵.

³⁰ Kodi Zgjedhor, neni 84 pika 5.

³¹ [Tarifat e medias për zgjedhjet e pjesshme 2022](#)

³² Konkretisht media SYRI Televizion ka dorëzuar në KQZ, dhe për rrjedhim [publikuar në faqen e internetit](#) të kësaj të fundit, një listë çmimesh në të cilën specifikon se “Reklamata e partive/organizatave politike nuk janë subjekt i këtyre tarifave”.

³³ Kodi Zgjedhor, neni 84 pika 5.

³⁴ Për më shumë shih [Raporti Final i Vëzhgimit](#) pjesa VIII.2.2.3. Shpenzimet për media, faqe 85.

³⁵ Për më shumë shih Shtojcën 3 “Fondet e shpenzuara dhe të deklaruara nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët për media.”

Shpenzimet për media sociale

Aktualisht, i vetmi shpenzim i fushatës zgjedhore që mund të bëhet transparent në mënyrë të pavarur, janë shpenzimet për reklama në Facebook, falë mekanizmit të transparencës³⁶ të ndërtuar nga vetë rrjeti social në lidhje me reklamat politike.

Page | 10

Në funksion të fushatës elektorale u shpenzuan rreth 6500 USD për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, 5500 USD nga kandidatët dhe 1000 USD nga partitë politike në garë. Nga këto 46% janë shpenzuar për reklama për llogari të kandidatëve të Partisë Demokratike, 16% janë shpenzuar për reklama për llogari të kandidatëve të Partisë Socialiste dhe 36% janë shpenzuar për reklama për llogari të kandidatëve të Koalicionit Shtëpia e Lirisë.

Sikurse në 2021, vërehen sërish mospërputhshmëri mes asaj që deklarohet dhe shumës që realisht shpenzohet. Kështu, evidentohet një kandidat i cili ka kryer pagesa për reklama të tilla por nuk e ka deklaruar, një kandidat i cili i ka deklaruar pjesërisht shpenzimet dhe 3 kandidatë të cilët nuk kanë dorëzuar fare raport vetëdeklarimi në KQZ³⁷, por kanë kryer pagesa në Facebook dhe Instagram.

Në total rezulton që janë deklaruar 312.000 lekë shpenzime për media sociale, ndërkohë që shpenzimi nga kontrolli është thujse 700.000 lekë³⁸. Diferenca, rreth 390.000 lekë gjykohet të jetë më e madhe për shkak se në deklarime përfshihet çdo shpenzim në zërin media sociale, që përfshin jo vetëm Facebook dhe Instagram, ndërkohë që kontrolli është vetëm për këto dy të fundit.

Reklamat janë gjeneruar kryesisht nga faqet zyrtare të kandidatëve dhe më pak nga faqet zyrtare të partisë apo nga faqet e degëve të partisë në rrethe. Kandidati që ka shpenzuar shumën më të madhe për reklamime në Facebook dhe Instagram është Ardian Muka me 1506 dollarë, i ndjekur nga Indrit Sefa me 1313 dollarë të paguara për faqen Partia Demokratike dega Lushnjë.

Nga 19 kandidatë për kryetarë bashkie pjesëmarrës në zgjedhjet e datës 6 mars 2022, për dymbëdhjetë prej tyre është paguar, nga partia apo vetë kandidatët, për reklamë në Facebook dhe Instagram.

2 kandidatë kanë kryer shpenzime për reklamë në Facebook dhe Instagram, por nuk i kanë deklaruar ato, ndërkohë që 3 kandidatë nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi por rezulton të kenë kryer shpenzime për reklamë në Facebook dhe Instagram³⁹.

³⁶ Shih [Librarinë e reklamave në Facebook për Shqipërinë](#)

³⁷ Për më shumë shih Shtojcën 4 “Shpenzimet e kryera nga subjektet zgjedhore për reklama politike në Facebook dhe Instagram.

³⁸ Kursi i këmbimit për kryerjen e llogaritjes është 1 USD=107.6 lekë, i cili është kursi mesatar i këmbimit në muajin shkurt dhe mars.

³⁹ Për më shumë shih Shtojcën 4 “Shpenzimet e kryera nga subjektet zgjedhore për reklama politike në Facebook dhe Instagram

KONTROLLI

Kuadri ligjor përcakton dy mekanizma bazë me anë të të cilave kontrollohen financat e subjekteve zgjedhore: monitorimin përgjatë fushatës zgjedhore dhe auditimin ligjor, i cili kryhet nga auditues ligjorë të kontraktuar nga KQZ.

Page | 11

Raportet e monitorimit

Duke nisur nga data 14 shkurt, KQZ emëroi⁴⁰ dhe angazhoi 20 monitorues⁴¹ të fushatës zgjedhore me synim rritjen e transparencës dhe vlerësimin e pavarur të aktiviteteve të fushatës. Monitoruesit dorëzuan në KQZ respektivisht 2 raporte të ndërmjetme dhe 1 raport përfundimtar të monitorimit të kryer.

Sikurse në vitin 2021, por në ndryshim nga zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2017, monitoruesit e aktiviteteve të fushatës nuk kanë për qëllim të nxjerrin kosto të pavarura të fushatës, por vetëm të monitorojnë aktivitetet, përfshirë aktivitetet e institucioneve shtetërore si dhe shkelje eventuale të kuadrit ligjor në terren.

Evidentohet si problem plotësimi i raporteve përfundimtare nga ana e monitoruesve. Në disa raste ato janë dorëzuar bosh⁴² në KQZ, në disa të tjera⁴³ të plotësuara shumë pak. Mungesa e përgjegjshmërisë prej monitoruesve, në përmbushjen e detyrave të tyre, ndikon drejtpërsëdrejti në përmbushjen e qëllimit për të cilin kjo hallkë e kontrollit u bë pjesë e ligjit, por edhe në mundësitë e kontrolleve apo kryqëzimit të të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Duke vlerësuar rolin tejet të rëndësishëm të monitoruesve, duhet një parapërgatitje më e lartë e tyre lidhur me çfarë duhet të monitorojnë, si dhe mbikëqyrje më strikte nga ana e KQZ.

Raportet e auditimit të subjekteve zgjedhore

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 6 mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëroi⁴⁴ tre auditues ligjorë, të zgjedhur më short, për pesë parti politike.

Auditimi i fondeve konsiston në kontrollin, auditimin, e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit me qëllim nxjerrjen e një opinioni me siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Pavarësisht kësaj ekziston një rrezik i

⁴⁰ [Vendimi nr. 23 datë 27.01.2022](#) i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

⁴¹ Për bashkinë Durrës 7 monitorues; Për bashkinë Vorë 1 monitorues; Për bashkinë Rrogozhinë 1 monitorues; Për bashkinë Shkodër 5 monitorues; Për bashkinë Dibër 2 monitorues; Për bashkinë Lushnjë 4 monitorues.

⁴² [Raporti përfundimtar i Monitoruesit G.B.](#); [Raporti Përfundimtar i Monitoruesit O.C.](#)

⁴³ Raporti Përfundimtar i [Monitoruesit K.Z.](#); Raporti Përfundimtar i [Monitoruesit P.P.](#); Raporti Përfundimtar i [Monitoruesit E.F.](#); Raporti Përfundimtar i [Monitoruesit A.Z.](#); Raporti Përfundimtar i [Monitoruesit S.B.](#)

⁴⁴ [Vendimi nr. 138 datë 18.03.2022](#) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi kryhet në përputhje me SNA-të.

Puna e ekspertëve kontabël, të kontraktuar si auditues ligjorë zgjedhorë prej KQZ, konkludon në dorëzimin e raportit të auditimit, i cili ka pjesën analitike dhe në përfundim opinionin e auditit.

Page | 12

Nga gjykimi final i auditëve mbi veprimtarinë financiare të lidhur me fushatën zgjedhore, për 2 subjekte⁴⁵ është konkluduar në opinion me rezervë, për 3 subjekte⁴⁶ auditit ka konkluduar në opinion pa rezervë.

Auditimi i realizuar nga ekspertët ligjorë është sipërfaqësor, pa u thelluar në disa elemente të rëndësishëm të veprimtarisë financiare të partive si dhe duke përmendur shkelje nga kandidatët por pa cituar emrin e tyre. Mbetet shqetësuese paraqitja e raporteve të paplota, në shumicën e përmbajtjes së tyre të paplotësuara nga ana e auditëve.

Kandidatët e partisë demokratike, përpos se nuk kanë paraqitur raport vetëdeklarimi, mbeten edhe të pa audituar nga auditit i caktuar nga KQZ, duke mbetur kështu totalisht jashtë çdo hallke raportimi e kontrolli të përcaktuar nga ligji.

Probleme të veprimtarisë financiare të subjekteve të evidentuara nga auditët:

- ✓ Në disa raste shpenzimet e kandidatëve nuk ishin me faturë tatimore por vetëm me kupon tatimor ose e anasjellta⁴⁷.
- ✓ Parti politike⁴⁸ dhe kandidatë⁴⁹ të cilët nuk kanë hapur llogari të posaçme bankare.
- ✓ Mosparaqitja e shpenzimeve të degëve dhe kandidatëve⁵⁰.

⁴⁵ Partia Socialiste dhe Partia Demokratike.

⁴⁶ Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, partia Lëvizja e Re dhe Partia Demokristiane.

⁴⁷ Disa kandidatë të Partisë Socialiste. Emrat përkatës nuk janë specifikuar në raportin e auditit.

⁴⁸ Partia Demokratike.

⁴⁹ Kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Durrës Znj. Emirjana Sako. Tre kandidatë të Koalicionit Shtëpia e Lirisë, emri i të cilëve nuk thuhet në raportin e auditimit të LSI.

⁵⁰ Partia Demokratike.